LIGJ
Nr. 57/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN "PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË SHËNDETËSISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndër-kombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin "Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.5.2015

Shpallur me dekretin nr. 9138, datë 16.6.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

HUAJA NR.---AL

MARRËVESHJE HUAJE

PROJEKTI PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË SHËNDETËSISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë _____, 2015

Marrëveshje e datës _____, 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Kushte të përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat që fillojnë me germa kapitale, të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet e shpjeguara në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara ose të

përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej tridhjetë e dy milionë e njëqind mijë eurosh (€ 32,100,000) (Hua), ku kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet kursit të këmbimit të monedhës, në pajtim me dispozitat e seksionit 2.08 të kësaj Marrëveshjeje (Huaja), për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në grafikun 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë fondet e Huas në përputhje me seksionin IV, të grafikut 2, të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Komisioni i administrimit, i pagueshëm nga Huamarrësi, është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.04 Komisioni i angazhimit, i pagueshëm nga Huamarrësi, do të jetë i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së Huas gjendje që nuk është tërhequr.

2.05 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi, për çdo periudhë interesi, është me një normë të barabartë me Normën e Referencës për monedhën e Huas plus Marzhin Fiks, me kusht që për një këmbim të të gjithë ose të një pjese të shumës principale të Huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi, gjatë periudhës së këmbimit për këtë shumë, të përcaktohet në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit 4 të kushteve të përgjithshme. Pavarësisht sa më sipër, nëse një shumë e balancës së tërhequr të Huas mbetet e papaguar kur bëhet e kërkueshme dhe kjo mospagesë vazhdon për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi llogaritet sipas parashikimit në seksionin 3.02/e të kushteve të përgjithshme.

2.06 Datat e pagesave janë 15 maji dhe 15 nëntori të çdo viti.

2.07 Shuma principale e Huas shlyhet në pajtim me afatin e amortizimit të parashikuar në dispozitat e pjesës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.08 a) Huamarrësi mund të kërkojë, në çdo kohë, një prej konvertimeve të mëposhtme të termave të Huas, me qëllim që të lehtësohet menaxhimi i arsyeshëm i borxhit: i) ndryshimin e monedhës së Huas për të gjithë ose për një pjesë të shumës principale të Huas, të tërhequr ose të patërhequr, në një monedhë të aprovuar; ii) ndryshimin e bazës të normës së interesit të zbatueshme, për: A) të gjithë ose një pjesë të shumës principale të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga një Normë e Ndryshueshme te një Normë Fikse ose anasjellas; ose B) të gjithë ose një pjesë të shumës principale të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga një normë e ndryshueshme e bazuar te një normë reference dhe marzhi i ndryshueshëm te një normë e ndryshueshme bazuar në një normë reference fikse dhe marzhin e ndryshueshëm ose anasjellas; ose C) të gjithë shumën principale të Huas, të tërhequr dhe të pakthyer nga një normë e ndryshueshme bazuar në një marzh të ndryshueshëm te një normë e ndryshueshme bazuar në një marzh fiks; dhe iii) caktimin e kufijve për normën e ndryshueshme ose normën e referencës të zbatueshme për të gjithë ose për një pjesë të shumës principale të Huas së tërhequr dhe të pakthyer nga vendosja e një tavani të normës së interesit ose e normës së interesit brenda një intervali të caktuar me një normë të ndryshueshme ose normë reference.

b) Çdo këmbim i kërkuar sipas paragrafit "a" të këtij seksioni, që pranohet nga Banka, konsiderohet "Këmbim", sipas përkufizimit në kushtet e përgjithshme dhe realizohet në pajtim me dispozitat e nenit 4 të kushteve të përgjithshme dhe të udhëzimeve për këmbimin.

c) Menjëherë pas datës së ekzekutimit për një tavan të normës së interesit ose një normë interesi brenda një intervali të caktuar, për të cilin Huamarrësi ka kërkuar që primi të paguhet nga fondet e Huas, Banka, në emër të Huamarrësit do të tërheqë nga llogaria e Huas dhe do t'i paguajë vetes shumat e kërkueshme për të paguar çdo prim të pagueshëm në përputhje me seksionin 4.05/c të kushteve të përgjithshme deri në shumën e caktuar herë pas here për qëllimin në tabelën në seksionin IV, të pjesës 2, të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivin e Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi

do të zbatojë Projektin nëpërmjet MSH-së në përputhje me dispozitat e nenit 5 të kushteve të përgjithshme.

3.02 Pa cenuar dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe përveç kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi garanton që Projekti të zbatohet në përputhje me dispozitat e pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Hyrja në fuqi; zgjidhja

4.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi përbëhen nga sa më poshtë:

a) Huamarrësi, nëpërmjet MSH-së, ka përgatitur dhe ka miratuar një Manual të Funksionimit të Projektit, të pranueshëm për Bankën si në formë edhe në përmbajtje;

b) Huamarrësi, nëpërmjet MSH-së, ka ngritur një NJMP me burime të mjaftueshme dhe ka punësuar një menaxher projekti, një specialist të menaxhimit financiar dhe një specialist prokurimi me kualifikime dhe me përvojë të kënaqshme për Bankën.

4.02 Afati i hyrjes në fuqi është 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së kësaj Marrë-veshjeje.

Neni 5

Përfaqësimi, adresat

5.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave i Huamarrësit.

5.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri
Faks: 355 42228494

5.02 Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Adresa kabllore:
INTBAFRAD
Washington, D.C.
Teleks: 248423(MCI) or 64145(MCI)
Faks: 1-202-477-6391

Rënë dakord në Tiranë, Republika e Shqipërisë, në ditën dhe vitin e shënuar më sipër.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: _____
Pozicioni: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: _____
Pozicioni: _____

PJESA 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është që të kontribuojë në: a) përmirësimin e efikasitetit të kujdesit në spitalet e përzgjedhura në territorin e Huamarrësit; b) përmirësimin e menaxhimit të informacionit në sistemin shëndetësor; dhe c) rritjen e aksesit financiar për shërbime shëndetësore.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Përmirësimi i shërbimeve spitalore

a) Realizimi i veprimtarive për të fuqizuar rrjetin spitalor të Huamarrësit, duke përfshirë:

i) shqyrtimin dhe përditësimin e masterplanit spitalor ekzistues;

ii) pilotimin në të paktën tri qarqe të Huamarrësit, zbatimin e masterplanit të rishikuar në spitalet që do të transformohen në mjedise diagnostikuese të kujdesit parësor;

iii) realizimin e një vlerësimi për menaxhimin aktual të Qendrës Spitalore Universitare dhe rekomandimin e përmirësimeve përkatëse;

iv) shqyrtimin e kuadrit rregullator ligjor dhe administrativ të spitalit në funksion të rritjes së autonomisë dhe të llogaridhënies në shërbimet spitalore dhe, nëse është e zbatueshme, rekomandimin e një përmirësimi të kuadrit të sipërpërmendur;

v) ngritjen e kapacitetit të ekipeve të menaxhimit të spitaleve, MSH-së, FSSH-së dhe agjencive të tjera mbikëqyrëse shëndetësore, në lidhje me planifikimin e shërbimit, alokimin e burimeve, menaxhimin e performancës dhe monitorimin e zbatimit dhe kontraktimin;

vi) përgatitjen e standardeve dhe treguesve për të profilizuar performancën spitalore të krahasueshme;

vii) përditësimin, zbatimin dhe monitorimin e udhëzimeve dhe të standardeve klinike për referimet spitalore;

viii) pilotimin e mekanizmave të llogaridhënies sociale bazuar te pacientët, si p.sh., linjat telefonike falas dhe reagime nëpërmjet telefonave celularë për të rritur reagimet e pacientëve dhe për të reduktuar pagesat informale;

ix) zhvillimin e llogarive kombëtare shënde-tësore për të mbështetur punën analitike në lidhje me buxhetin në sektorin e shëndetësisë;

b) rehabilitimin dhe/ose përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve mjekësore të spitaleve të përzgjedhura në bazë të masterplanit spitalor; dhe

c) ngritjen e një qendre shëndetësore kombëtare dhe përgatitjen e një strategjie për të mirëmbajtur pajisjet mjekësore në sektorin e shëndetit publik.

Pjesa 2. Zgjerimi i sistemit të menaxhimit të informacionit shëndetësor/e- Health

a) Kryerja e veprimtarive për të përmirësuar saktësinë dhe zotërimin në kohë të informacionit klinik, financiar dhe administrativ brenda dhe ndërmjet spitaleve rajonale, duke përfshirë:

i) zhvillimin e një masterplani për SMIS-në dhe për veprimtaritë e e-Health, një fjalori për të dhënat shëndetësore dhe një modeli të të dhënave shëndetësore; dhe

ii) krijimin e një qendre kombëtare për informacionin shëndetësor (Qendra Kombëtare e Informacionit Shëndetësor) dhe të regjistrave bazë për SMIS-në;

b) realizimi dhe zbatimi i një sistemi të informacionit spitalor në spitalet rajonale të përzgjedhura dhe kryerja e trajnimit përkatës për punonjësit e spitaleve rajonale të sipërpërmendura;

c) zbatimi i një sistemi të ri informacioni për sigurimet shëndetësore që FSSH-ja të automatizojë përpunimin e kërkesave të sigurimit shëndetësor dhe të përmirësojë mbikëqyrjen ndaj sistemit që realizon kujdesin shëndetësor, duke përfshirë edhe trajnimin e punonjësve përkatës të FSSH-së.

Pjesa 3. Përmirësimi i sistemit të financimit të shëndetësisë

a) Kryerja e veprimtarive për të mbështetur reformat në sistemin e pagesave në kujdesin parësor dhe spitalor, duke përfshirë fuqizimin e kapacitetit të FSSH-së për të mbledhur dhe shfrytëzuar të dhënat

shëndetësore dhe futjen në përdorim të shumës vjetore për t'u paguar nga siguruesi i shëndetit për mjekun për çdo person të siguruar.

b) Shuma vjetore për t'u paguar nga siguruesi i shëndetit për mjekun për çdo person të siguruar për kujdesin parësor si dhe sistemin e pagesës për grupin e lidhur me diagnozat për spitalet.

c) Hartimi dhe pilotimi i politikave farmaceutike, të cilat reduktojnë koston dhe përmirësojnë aksesin ndaj barnave që mund të përballohen financiarisht.

Pjesa 4: Monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i Projektit

Krijimi dhe rritja e kapacitetit të NJKP-së për të realizuar veprimtaritë e projektit, duke përfshirë: a) kryerjen e menaxhimit të deleguar si një palë e tretë, veprimtaritë monitoruese dhe vlerësuese; b) realizimin e anketimeve që lidhen me projektin; dhe

c) zbatimin e një strategjie komunikimi për reformat në shëndetësi.

PJESA 2
ZBATIMI I PROJEKTIT

Seksioni I
Masat institucionale dhe zbatuese

A. Masat institucionale

1. Huamarrësi:

a) nëpërmjet MSH-së, është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme dhe zbatimin e Projektit.

b) nëpërmjet MSH-së, do të krijojë dhe do të mbajë gjatë të gjithë zbatimit të Projektit një NJKP me punonjësit kyç, duke përfshirë një menaxher projekti, një specialist për menaxhimin financiar dhe një specialist prokurimi me kualifikime, përvojë dhe terma reference të pranueshëm për Bankën.

2. Gjatë zbatimit të pjesës 2 (a) (ii) të Projektit, Huamarrësi, jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e hyrjes në fuqi do të krijojë, do të mbajë në funksionim dhe do të mirëmbajë Qendrën Kombëtare të Informacionit Shëndetësor që do të ketë strukturë, funksion dhe burime të kënaqshme për Bankën.

B. Masat e zbatimit

Manuali i funksionimit të Projektit

Pa cenuar dispozitat e nenit 5 të kushteve të përgjithshme, Huamarrësi, nëpërmjet MSH-së do të garantojë që:

i) Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit; dhe

ii) Manuali i funksionimit të Projektit ose ndonjë pjesë e tij të mos ndryshohet, hiqet dorë, pezullohet ose shfuqizohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës dhe në çdo rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të Manualit të Funksionimit të Projektit dhe ato të kësaj Marrëveshjeje, do të kenë përparësi dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

C. Antikorrupsioni

Huamarrësi do të garantojë realizimin e Projektit në përputhje me dispozitat e udhëzimeve antikorrupsion.

D. Politikat mbrojtëse

1. Në zbatimin e pjesës 1/b të Projektit, Huamarrësi nëpërmjet MSH-së:

i) do të zbatojë pjesën e sipërpërmendur të Projektit në përputhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor, në një mënyrë të kënaqshme nga Banka; dhe

ii) do të vërë në dispozicion të Bankës për miratim paraprak çdo ndryshim që propozohet për PMM-në e sipërpërmendur dhe ta realizojë atë ndryshim të PMM-së, vetëm siç do të jetë rënë dakord me Bankën.

2. Në rast konflikti ndërmjet PMM-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të kenë përparësi dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MSH-së, do të garantojë që termat e referencës të çdo konsulence në lidhje me projektin pas shqyrtimit nga Banka, do të jenë të pranueshme për të dhe për këtë qëllim, këta terma reference do të përfshijnë kriteret e politikave mbrojtëse të Bankës në fuqi në atë kohë, të cilat zbatohen ndaj këshillimit të realizuar nëpërmjet kësaj asistence teknike.

Seksioni II
Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit

A. Raportet e Projektit

Huamarrësi do të monitorojë dhe do të vlerësojë progresin e Projektit dhe do të përgatitë raportet e Projektit, në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të kushteve të përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën. Çdo raport i Projektit do të mbulojë periudhën e gjashtë muajve dhe do t'i paraqitet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe kontrollet financiare

1. Huamarrësi, nëpërmjet MSH-së, do të mbajë ose do të marrë masa për mbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MSH-së, do të përgatitë dhe do t'i paraqesë Bankës jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, raportet financiare paraprake të pakontrolluara për Projektin që mbulojnë tremujorin, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën.

3. Pasqyrat financiare të Huamarrësit, nëpërmjet MSH-së, duhet të kontrollohen në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09/b të kushteve të përgjithshme. Çdo kontroll financiar i pasqyrave financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat financiare të kontrolluara për çdo periudhë të tillë duhet t'i paraqiten Bankës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

Seksioni III
Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente që kërkohen për Projektin dhe që financohen nga fondet e Huas, duhet të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara ose të përmendura në seksionin I të udhëzimeve për prokurimin dhe në dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulencës, të nevojshme për Projektin dhe që financohen nga fondet e Huas, duhet të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara ose të përmendura në seksionet I dhe IV të udhëzimeve për konsulentët dhe në dispozitat e këtij seksioni.

2. Përkufizime. Termat me germa kapitale, të përdorur më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metodat e rishikimit nga Banka të kontratave të veçanta, i referohen metodës korresponduese të përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve për prokurimin ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve për konsulentët, sipas rastit.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente

1. Tenderi i hapur ndërkombëtar. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente duhet të prokurohen sipas kontratave që lidhen mbi bazën e tenderit të hapur ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente. Përveç tenderit të hapur ndërkombëtar për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve jokonsulente për ato kontrata që specifikohen në Planin e Prokurimit mund të përdoren metodat e mëposhtme: a) Tender i hapur kombëtar, në varësi të dispozitave që parashikohen në paragrafin 3 të këtij seksioni; b) Blerja; dhe c) Kontraktimi i drejtpërdrejtë.

3. Ndryshimet në procedurat e tenderit të hapur kombëtar të Huamarrësit. Procedurat e tenderit të hapur kombëtar (THK) duhet të bazohen në procedurat e tenderimit të hapur, siç përcaktohen në ligjin e prokurimit publik (LPP) të Shqipërisë (ligji nr. 9643 i datës 20 nëntor 2006, i ndryshuar), me kusht që kjo procedurë të jetë objekt i dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të udhëzimeve për prokurimin dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

a) Procedurat e "Tenderit të hapur", siç përcaktohen në LPP të Shqipërisë, do të zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

b) Ofertuesit e huaj nuk duhet të përjashtohen nga ofertimi dhe asnjë preferencë e asnjë lloji nuk u jepet ofertuesve vendës në procesin e ofertimit. Ndërmarrjet në pronësi të qeverisë në Shqipëri lejohen të paraqesin ofertat e tyre vetëm nëse janë ligjërisht dhe financiarisht autonome dhe operojnë sipas ligjit tregtar të Huamarrësit. Regjistrimi nuk duhet të përdoret si kriter kualifikues për ofertuesit;

c) Ofertat duhet të hapen në publik, në një vend, menjëherë pas afatit përfundimtar për dorëzimin e ofertave në prani të përfaqësuesve që dëshirojnë të marrin pjesë;

d) Subjektet prokuruese përdorin dokumente tip tenderimi të aprovuara nga Banka;

e) Në rastin e çmimeve më të larta të ofertës, në krahasim me vlerësimin zyrtar, asnjë nga ofertat nuk duhet të refuzohen pa pëlqimin paraprak të Bankës;

f) Për paraqitjen e ofertave do të përdoret procedura me një zarf të vetëm;

g) Paskualifikimi duhet të zhvillohet vetëm për ofertuesin e vlerësuar me ofertën më të ulët; asnjë ofertë nuk duhet të refuzohet në momentin e hapjes së ofertës për shkak të kualifikimit;

h) Subjektet që paraqesin ofertë në formën e një ndërmarrjeje të përbashkët duhet të konsiderohen përgjegjës bashkërisht dhe individualisht;

i) Para refuzimit të të gjitha ofertave dhe kërkimit të ofertave të reja, duhet të merret pëlqimi paraprak i Bankës;

j) Kontratat duhet t'i jepen ofertuesit që vlerësohet se ka paraqitur ofertën më të ulët, që është kryesisht përgjegjës, i cili është përcaktuar të jetë i kualifikuar të kryejë aktivitetin në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe të parashpallura të vlerësimit;

k) Nuk do të lejohen negociata pas ofertimit as me subjektin që pa paraqitur ofertën më të ulët, as me ndonjë subjekt tjetër ofertues;

l) Kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më shumë se 18 muaj) duhet të përmbajnë dispozita të përshtatshme për rregullimin e çmimit, të pranueshme nga Banka;

m) Garancitë e ofertës dhe të kontratës duhet të jenë në formën e përfshirë në dokumentet e tenderit, të përmendura në paragrafin "d" më sipër. Garancia e ofertës duhet të jetë e vlefshme për 28 (njëzet e tetë) ditë pas periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës ose pas çdo periudhe shtyrjeje, nëse kërkohet. Asnjë pagesë paradhënieje nuk duhet të kryhet pa një garanci të përshtatshme paradhënieje;

n) Dokumentet e tenderit dhe kontrata, siç konsiderohen të pranueshme nga Banka, duhet të përfshijnë dispozita që përcaktojnë politikën e Bankës për të sanksionuar firmat ose individët që konstatohen të përfshirë në mashtrim dhe korrupsion sipas përcaktimeve të udhëzimeve për prokurimin;

o) Në përputhje me udhëzimet e prokurimit, çdo dokument ofertimi dhe kontratë e financuar nga shumat e Huas duhet të parashikojë që ofertuesit, furnitorët dhe kontraktorët dhe nënkontraktorët e tyre, agjentët, personeli, konsulentët, ofruesit e shërbimeve ose furnitorët të lejojnë Bankën të inspektojë të gjitha llogaritë, të dhënat dhe dokumentet e tjera në lidhje me paraqitjen e ofertave dhe realizimin e kontratës dhe të kontrollohen nga auditues të caktuar nga Banka. Pa u kufizuar te dispozitat e parashikuara në paragrafin 1.16/a/v/bb të Udhëzimeve për Prokurimin, veprimet që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e së drejtës së Bankës për inspektim dhe kontroll financiar të parashikuar në udhëzimet për prokurimin, do të konsiderohen si një praktikë penguese sipas përkufizimeve në udhëzimet e prokurimit.

C. Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe në kosto. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më

poshtë, shërbimet e konsulentëve duhet të prokurohen sipas kontratave të lidhura mbi bazën e përzgjedhjes së bazuar në cilësi dhe në kosto.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Përveç përzgjedhjes së bazuar në cilësi dhe në kosto për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve, për ato detyra që specifikohen në planin e prokurimit, mund të përdoren metodat e mëposhtme: a) Përzgjedhja e bazuar në cilësi; b) Përzgjedhja sipas një buxheti fiks; c) Përzgjedhja e bazuar në koston më të ulët; d) Përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; e) Procedurat e parashikuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzimeve për konsulentët për përzgjedhjen e konsulentëve individualë; f) Përzgjedhja nga një burim i vetëm i firmave konsulente; dhe g) Procedurat me një burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

D. Rishikimi nga Banka i vendimeve të prokurimit

Plani i prokurimit përcakton ato kontrata që do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit të mëpasshëm të Bankës.

Seksioni IV
Tërheqja e fondeve të Huas

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat nga Huaja në përputhje me dispozitat e nenit 2 të kushteve të përgjithshme në këtë seksion dhe me udhëzimet e tjera shtesë të Bankës, siç specifikohen prej saj dhe i njoftohen Huamarrësit (duke përfshirë "Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet", të botuara në maj 2006, siç rishikohen herë pas here nga Banka dhe siç zbatohen në këtë Marrëveshje në përputhje me këto udhëzime), për financimin e shpenzimeve të pranueshme, siç parashikohet në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të pranueshme, që mund të financohen nga të ardhurat nga Huaja (kategori), ndarjen e shumave të Huas për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për shpenzimet e pranueshme në secilën kategori.

Kategoria	**Shuma e Huas së alokuar (e shprehur në euro)**	**Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (duke përfshirë taksat)**
1. Punime	6,760,000	63%
2. Mallra, shërbime jokonsulente	18,360,000	100%
3. Shërbime konsu-lence, trajnim dhe kosto operative	6,500,000	100%
4.Komisioni i administrimit	80,250	Shuma të pagueshme në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07/b të kushteve të përgjithshme
5. Tavani i normës së interesit ose primi i normës së interesit brenda një intervali të caktuar	0	Shumë e kërkueshme në përputhje me seksionin 2.08/c të kësaj Marrëveshjeje
6. Të paalokuara	399,750	
SHUMA TOTALE	32,100,000	

B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e kryera para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç rastit kur tërheqjet janë deri në një shumë të përgjithshme që nuk kalon ekuivalentin e 100,000 eurosh, që mund të bëhet për pagesat e kryera para kësaj date, por në ose pas datës 1 janar 2015 për shpenzimet e pranueshme.

2. Data e mbylljes është 28 shkurti 2021.

PJESA 3

1. Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huas që paguhet në çdo datë të pagesës së principalit (pjesa e kështit). Nëse fondet e Huas janë tërhequr plotësisht brenda datës së parë të pagesës së principalit, shuma principale e Huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) Balancën e tërhequr të Huas brenda datës së parë të pagesës së principalit; me b) Pjesën e kështit për çdo datë të pagesës së principalit.

Data e pagesës së principalit	**Pjesa e kështit (e shprehur në përqindje)**
Më 15 maj dhe 15 nëntor Duke filluar nga data 15 maj 2022 deri më 15 nëntor, 2036	3.23%
Në datën 15 maj 2037	3.10%

2. Nëse shumat e Huas nuk janë tërhequr plotësisht brenda datës së parë të pagesës së principalit, shuma principale e Huas, e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit, përcaktohet si më poshtë:

a) Kur një shumë e Huas është tërhequr deri në datën e parë të pagesës së principalit, Huamarrësi shlyen balancën e tërhequr të Huas deri në këtë datë në përputhje me paragrafin 1 të kësaj pjese;

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të pagesës së principalit do të shlyhet në çdo datë të pagesës së principalit pas datës së kësaj tërheqjeje në shumat e përcaktuara nga Banka, duke shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një thyesë, numëruesi i së cilës është pjesa fillestare e kështit në tabelën e paragrafit 1 të këtij grafiku, për këtë datë të pagesës së principalit (pjesa e kështit fillestar) dhe emëruesi i së cilës është shuma e të gjitha pjesëve të mbetura të kështit fillestar për datat e pagesës së principalit që bien në ose pas kësaj date kur këto shuma të shlyeshme duhet të përshtaten, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të përmendur në paragrafin 4 të këtij grafiku, për të cilin zbatohet konvertimi i monedhës.

3. a) Shumat e Huas, të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë para çdo date të pagesës së principalit, vetëm për qëllimet e llogaritjes së shumave të principalit të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit, duhet të trajtohen si të tërhequra dhe të pashlyera në datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes dhe do të jenë të shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që fillon në datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht dispozitave të nënparagrafit "a" të këtij paragrafi, nëse në një moment të caktuar Banka miraton një sistem faturimi me datë të kërkueshme, sipas të cilit faturat lëshohen në ose pas datës përkatëse të pagesës së principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk vazhdojnë të zbatohen për asnjë tërheqje të kryer pas miratimit të këtij sistemi faturimi.

4. Pavarësisht dispozitave të nënparagrafëve 1 dhe 2 të kësaj pjese, në momentin e konvertimit të monedhës së të gjithë ose të një pjese të balancës së Huas së tërhequr në një monedhë të miratuar, shuma e konvertuar në monedhën e aprovuar që është e shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që bie gjatë periudhës së konvertimit, do të përcaktohet nga Banka, duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e saj të përcaktuar menjëherë para konvertimit me: i) normën e këmbimit që reflekton shumat e principalit në monedhën e aprovuar nga Banka sipas transaksionit të sigurimit të monedhës në lidhje me konvertimin; ose ii) nëse Banka vendos në këtë mënyrë, në pajtim me udhëzimet e konvertimit, komponentin e normës së këmbimit të afishuar.

SHTOJCË

Seksioni I
Përkufizime

1. "Udhëzimet antikorrupsion" janë "Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe

korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s", të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar të vitit 2011.

2. "Politikat mbrojtëse të Bankës" do të thotë politikat dhe procedurat për funksionimin e Bankës, të parashikuara në manualin operacional dhe të identifikuara, si: OP/BP 4.01, 4.04, 4.09, 4.10, 4.11, 4.12, 4.36, 4.37, 7.50 dhe 7.60 të manualit të sipërpërmendur të publikuar në www.WorldBank.org/opmanual.

3. "Shuma vjetore për t'u paguar nga siguruesi i shëndetit për mjekun për çdo person të siguruar" do të thotë pagesat totale që janë bërë nga Huamarrësi për t'iu dhënë një njësie të kujdesit shëndetësor brenda një periudhe të përcaktuar kohore.

4. "Kategori" do të thotë një kategori e parashikuar në tabelën në seksionin IV të grafikut 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. "Udhëzimet për konsulentët" do të thotë "Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore", i muajit janar të vitit 2011 (i rishikuar në korrik 2014).

6. "Grupi i lidhur me diagnozat" do të thotë një sistem statistikor i klasifikimit të çdo pacienti të shtruar në spital nëpër grupe në lidhje me pagesat ndaj spitaleve.

7. "e-Health" do të thotë informacion shëndetësor elektronik.

8. "Plani i Menaxhimit Mjedisor" ose "PMM" është plani i Huamarrësit për pjesën 1/b të Projektit, i muajit qershor 2014, që ka formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, duke përfshirë edhe një listë kontrolli për zbutjen e ndikimeve të mundshme mjedisore, i cili jep hollësi të masave për menaxhimin e risqeve të mundshme mjedisore dhe që zbusin, reduktojnë dhe/ose kompensojnë ndikimet negative në mjedis, së bashku me masat institucionale, monitoruese dhe raportuese, që mund të sigurojnë zbatimin e duhur dhe reagime të rregullta mbi përputhshmërinë me kushtet e tij, pasi ky plan mund të ndryshohet ose plotësohet herë pas here me miratimin paraprak me shkrim nga Banka.

9. "Regjistrat bazë" do të thotë instrumentet e MSH-së të krijuara për të mbështetur MSH-në për të mbajtur dokumente kyçe për njësitë shëndetësore të MSH-së për punonjësit, godinat dhe pajisjet biomjekësore që janë të pajisura me teknologjinë dhe programet kompjuterike, të cilat mundësojnë që institucionet e shëndetit publik të kenë akses te këto dokumente kyçe.

10. "Kushte të përgjithshme" janë "Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim për Huat" të datës 12 mars 2012, me modifikimet e paraqitura në seksionin II të kësaj shtojce.

11. "Fondi i Sigurimeve Shëndetësore" ose "FSSH" është një agjenci qeveritare përgjegjëse për të menaxhuar financimin ndaj shëndetësisë, i cili është ngritur dhe funksionon në përputhje me një vendim të Këshillit të Ministrave, të datës 1 mars 1995 ose pasardhësi i tij i ligjshëm.

12. "Sistemi i menaxhimit të informacionit spitalor" ose "SMIS" do të thotë sistemi i informacionit i Huamarrësit i krijuar për të mbështetur menaxhimin e funksioneve kryesore në spitale.

13. "Masterplani i SMIS-it" është plani i Huamarrësit për sistemin e informacionit në lidhje me përmirësimin e koordinimit ndërmjet partnerëve për zhvillimin dhe paraqitjen e një strategjie për Huamarrësin për përqendrimin e investimeve të tij në njësitë e kujdesit shëndetësor të sektorit shëndetësor.

14. "Masterplani spitalor" ose "MPS" është plani kombëtar i Huamarrësit i muajit prill 2012 për racionalizimin e spitaleve publike.

15. "MSH" do të thotë Ministria e Shëndetësisë ose pasardhësi i saj i ligjshëm.

16. "Llogari Kombëtare Shëndetësore" ose "LLKSH" janë treguesit e harmonizuar, të integruar dhe të krahasueshëm të Huamarrësit për të dhënat e shpenzimeve vjetore nga njësi shëndetësore publike dhe private.

17. "Qendra Kombëtare e Informacionit Shëndetësor" ose "QKISH" është qendra që do të krijohet nga Huamarrësi, me qëllim që të rritet qëndrueshmëria e nismave e-health/ SMIS dhe të sigurohen instrumente moderne për të mbështetur përdoruesit.

18. "Kostot operative" janë shpenzime të arsyeshme që rriten gradualisht, të cilat lindin gjatë Projektit dhe që përbëhen nga shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve, dietat për nëpunësit publikë (me përjashtim të pagave të nëpunësve publikë të qeverisë) për blerjen e pajisjeve për zyra, furnizime, kostot e komunikimit, reklamave dhe kostot e karburantit për vizitat në terren.

19. "Njësia e Koordinimit të Projektit" ose "NJKP" është një njësi që përmendet në seksionin 1.A.1/b të kësaj Marrëveshjeje.

20. "Udhëzimet për prokurimin" janë "Udhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe i shërbimeve jokonsulente në kuadrin e huave të IBRD-së dhe krediteve e granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 (i rishikuar në korrik 2014).

21. "Plan prokurimi" është plani i prokurimit i Huamarrësit për Projektin, i datës 23 dhjetor 2014 dhe i përmendur në paragrafin 1.18 të udhëzimeve për prokurimin dhe paragrafin 1.25 të udhëzimeve për konsulentët, i cili do të përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve të sipërpërmendur.

22. "Manuali i funksionimit të Projektit" është manuali i Huamarrësit i pranueshëm për Bankën dhe që paraqet politikat dhe procedurat që aplikohen për zbatimin e Projektit, të cilat përfshijnë, ndër të tjera: a) rolet dhe përgjegjësitë e secilës prej agjencive ose enteve të përfshira në zbatimin e Projektit; b) kërkesat për punonjës për Projektin; c) afatet në të cilat vlerësohet se do të zbatohet Projekti; c) procedurat për të pasur akses, disbursuar dhe raportuar për fondet e Projektit; d) treguesit që duhet të përdoren për monitorimin dhe vlerësimin e Projektit; e) procedurat për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e Projektit, duke përfshirë formën dhe përmbajtjen e raporteve të Projektit; dhe f) procedurat e prokurimit dhe ato financiare që mund të ndryshohen herë pas here me miratimin paraprak me shkrim nga Banka.

23. "Qendra Spitalore Universitare" është spitali kombëtar referues i Huamarrësit, që është krijuar dhe funksionon në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, i vitit 1993, ose pasardhësi i tij ligjor.

24. "Trajnim" do të thotë kosto të arsyeshme, të lidhura me pjesëmarrjen e personelit të përfshirë në veprimtari të Projektit në trajnime, seminare dhe ture studimore - këto kosto përbëhen nga kosto udhëtimi dhe dieta për pjesëmarrësit në trajnime, seminare dhe ture studimore, kosto që lidhen me sigurimin e shërbimeve të trajnerëve, marrjen me qira të mjediseve për trajnime dhe seminare, përgatitjen dhe shumëfishimin e materialeve për trajnimet dhe seminaret dhe kosto të tjera të lidhura drejtpërdrejt me kurse trajnimi, seminare ose përgatitjen e tureve studimore (por duke përjashtuar kostot e shërbimeve të konsulencës).

Seksioni II
Ndryshimet e kushteve të përgjithshme

Kushtet e përgjithshme ndryshohen si më poshtë:

1. Në tabelën e lëndës, referimet ndaj seksioneve, emrave të seksioneve dhe numrave të seksioneve ndryshohen për të reflektuar modifikimet e paraqitura në paragrafin e mëposhtëm.

2. Seksioni 3.01. (Komisioni i administrimit) ndryshohet si më poshtë:

"Seksioni 3.01. Komisioni i administrimit; Komisioni i angazhimit

a) Huamarrësi i paguan Bankës një komision administrimi për shumën e Huas me normën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas (Komisioni i administrimit).

b) Huamarrësi i paguan Bankës një komision angazhimi për gjendjen e patërhequr të Huas me normën që specifikohet në Marrëveshjen e Huas (Komisioni i angazhimit). Komisioni i angazhimit do të grumbullohet nga një datë gjashtëdhjetë ditë pas datës së Marrëveshjes së Huas deri në datat përkatëse në të cilat shumat tërhiqen nga Huamarrësi prej Llogarisë së Huas ose anulohen. Komisioni i angazhimit paguhet dy herë në vit me pagesa të prapambetura në secilën datë pagese.".

3. Te shtojca, përkufizimet, të gjitha referimet përkatëse ndaj numrave dhe paragrafëve të seksioneve

ndryshohen sipas nevojës për të reflektuar modifikimet e paraqitura në paragrafin 2 më sipër.

4. Shtojca ndryshohet duke shtuar një paragraf të ri 19, me përkufizimin e mëposhtëm të "Komisionit të angazhimit" dhe duke rregulluar numrat e paragrafëve vijues:

"19. "Komisioni i angazhimit" do të thotë Komisioni i angazhimit, i specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllim të seksionit 3.01/b.".

5. Në paragrafin e shtojcës që numrin e ri e ka 49 (fillimisht ishte paragrafi 48), përkufizimi i "Komisionit të administrimit" ndryshohet duke zëvendësuar referimin ndaj seksionit 3.01 me seksionin 3.01/a.

6. Në paragrafin që numrin e ri e ka 68 (fillimisht ishte paragrafi 67) të shtojcës, përkufizimi i termit "Pagesa e Huas" modifikohet si më poshtë:

"68. "Pagesa e Huas" është çdo shumë e pagueshme në Bankë nga Palët e Huas në përputhje me marrëveshjet ligjore ose kushtet e përgjithshme, duke përfshirë (por pa u kufizuar tek) çdo shumë të Huas së tërhequr, interesin, Komisionin e administrimit, Komisionin e angazhimit, normën e interesit për vonesa (nëse ka), çdo prim parapagimi, çdo tarifë transaksioni për një konvertim ose përfundim të hershëm konvertimi, normën e fiksuar me marzh të ndryshueshëm (nëse ka), çdo prim të pagueshëm me përcaktimin e tavanit të normës së interesit ose normës së interesit brenda një intervali të caktuar, dhe çdo shumë të nevojshme për mbylljen e pozicioneve të pagueshme nga Huamarrësi.".

7. Në paragrafin e shtojcës që numrin e ri e ka 73 (numri i paragrafit në fillim ishte 72), përkufizimi i "datës së pagesës" modifikohet duke fshirë fjalën "është" dhe duke vendosur fjalët "dhe Komisioni i angazhimit janë" pas fjalës "interes".